



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.199/2015

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditëses:                      të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim                      kundër të paditurit:                      nga Mitrovia, baza e kontestit: Borxh, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datën 09.07.2015 gjykata bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- **APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditëses              dhe kundër të paditurës              , lidhur me kthimin e borxhit për shfrytëzimin e linjës telefonike.
- **OBLIGOHET**, e paditura që brenda afatit 7 ditor nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën prej 96.27 euro ne emër te borxhit, për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm, në kamat vjetore sikurse per mjetet e afatizuara per periudh 1 vjeqare pa destinim te caktuar.
- **OBLIGOHET**, e padituri që brenda afatait 7 ditorë në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditëses shumën prej 15 euro në emër të takses per padi, ndersa 15 Euro ne emer të shpenzimeve gjyquesore-përpilimin e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditesja me datë: 16.03.2010 ka parashtruar padi në gjykatë për pagimin e borxhit që rrjedh nga Historiati I raportit mbi faturat dhe pagesat, dhe nga kontrata për pagimin e borxhit me këste, kundër të paditures              nga Mitrovica.

Në seancën e shqyrimit kryesor përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespatis, propozoj gjykatës adminstrimin e provave, shpenzimet e procedures I kërkoj.

Kurse sa I përket të paditurës në seancën e shqyrëtimit kryesor nuk

kushtevë ligjore gjykata ka zhvilluar procedurën me tutje pa prezencën e te paditurës.

Gjykata në sencen e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt 18.05.2015 administroi këto prova: Kopja e letërnjoftimit të paditurës, historiati I raportit mbi faturat dhe pagesat e datës së lëshimit 15.03.2010, si dhe kontrata për pagimin e borxhit me këste e dates 16.03.2009 e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurit

Gjykata në bazë të nenit 7 dhe 8 të LPK-se vlerësoi provat e paraqitura në gjykatë dhe erdhi në këtë konkludim:

Për gjykatën Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë shfrytëzues i shërbimeve telefonike, pasi kjo vërtetohet nga ana e historiatit të faturimit I cili është në emër të të paditurës

Po ashtu për gjykatën nuk është konstetsuese fakti se e paditura paditëses i ka borxh shumën e cekur në padi, pasi përmes nënshkrimit të kontratës mbi pagesën e borxhit me këste, e paditura pajtohet me borxhin prej 72,07 Euro borxh ky i cili ka rrjedh që nga muaji mars i vitit 2009 e deri në shtator të po këtij viti, mirëpo edhe pas lidhjes së kësaj kontrate e paditua ka krijuar shpenzime të reja, gjë që vërtetohet nga historiati i faturimit dhe pagesave ku kjo shumë arrin në 96.27 Euro për muajt tetor, nënëtor, dhjetor të vitit 2009 dhe muajin janar të vitit 2010.

Nga kjo gjykata vërteton se e paditura i ka borgj paditëses shumën prej në total prej 96.27 Euro për shkak te mos pagimit të shfrytëzimit të linjës telefonike.

Sa I përket të drejtës material gjykata u mbështet në nenin 17 të Ligjit për Marëdhëniet e Detyrimeve (Ligji i Vjetri) i zbatuar në këtë rast pasi detyrimi ka lindur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi.

Lidhur me kamaten e cekur ne pikën I te dispozitivit sa I perket te drejtës materiale gjykata u bazua ne nenin 277 te Ligjit për Marëdhëniet e Detyrimeve (Ligji i Vjetri).

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata obligon palen e cila e ka humb kontestin t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale, e kjo duke u bazuar ne nenin 452 paragrafi I të LPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.Nr.199/2015 datë: 09.07.2015**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditore nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.